

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	EMRAT/ Vrasja e Ferdinand Hotit në Itali, kush janë dy shqiptarët e akuzuar si porositës dhe ekzekutor
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/vrasja-e-shqiptarit-hoti-ne-itali-hetimet-cojne-drejt-rrjeteve-te-dro-i103696
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 16:24:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 16:18:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d8725da1b5bc4bfafc90ffbe18439dcc8b884eea147e40704c863e2ece32e2e9
TEKSTI	f5460ae27b8d968498ea617c359f18530deaeb2ad8175db256cd62803db05fd3
PAMJA	cd8fd8fdfb33d073d06c8f82f5a2bffc5e6269a384d11a3583a1266f319b014

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c179f91d3758a95268cee7a5be81531cf6d6a67cc7ae1781595bd403166e051
E MËPARSHMJA	876732e2bd2e2206193eb47a3ed31b6347ba32fb1b23ad748b56cb3f51a860ae
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7c179f91d3758a95268cee7a5be81531cf6d6a67cc7ae1781595bd403166e051>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

 SYRI LIVE



Flash: [Greqise, e](#) [shqiptar qe](#) [pamjattueshem](#) [shqiptaret](#) [ben](#) [auto](#)
[DEA dhe](#) [ra në](#) [e akuzuar](#) [kallëzim](#) [dys](#)
[nolicia](#) [të arrestuar](#) [kurthin e](#) [Mirano, po](#) [përqendrohen](#) [qëndër të](#) [vëmendjes](#)
[në botën e](#) [disa](#)

AKTUALITET

EMRAT/ Vrasja e Ferdinand Hotit në Itali, kush janë dy shqiptarët e akuzuar si porositës dhe ekzekutor

Piranjat Përditësimi i fundit 11 Shtator 2026, 18:18



 EMRAT/ Vrasja e Ferdinand Hotit në Itali, kush janë dy shqiptarët

Hetimet për vrasjen e Ferdinand Hotit, 35 vjeç, shqiptarit me banim në Mirano, po përqendrohen në botën e trafikut të drogës dhe në lidhjet e mundshme me rrjete kriminale në zonën e Venetos.

Mirano, në provincën e Venecias, konsiderohet nga hetuesit si një nga zonat e ndjeshme të trafikut të drogës përgjatë aksit Padova-Mestre-Jesolo. Pozicioni gjeografik, afërsia me autostradën dhe Riviera del Brenta, si dhe prania e rrugëve dytësore dhe banesave të izoluara, e kanë bërë këtë territor të rëndësishëm për rrjetet e shpërndarjes së drogës.

Pikërisht në këtë zonë çojnë disa prej gjurmëve të hetimit për vrasjen e Hotit, i cili u qëllua me armë zjarri dhe u gjet në një automjet Fiat Bravo, të përfunduar në lumin Tergola, në San Giorgio delle Pertiche.

Sipas hetuesve, mënyra e ekzekutimit ka ngritur edhe pistën e krimit të organizuar, ndërsa hetimet po zhvillohen në territorin e provincës së Venecias. Prokuroria e Padovës po ndjek si pistë kryesore mundësinë e një larjeje hesapsh të lidhur me ambientet e trafikut të drogës.

Atentat tjetër në Mirano, vetëm dy muaj më parë

Hetimi merr rëndësi edhe për shkak të një tjetër ngjarjeje të rëndë të ndodhur vetëm pak kilometra larg, dy muaj më parë.

Më 1 korrik, në Zianigo të Miranos, një i ri shqiptar u qëllua me armë zjarri në zonën mes klavikulës dhe qafës. Sipas hetimit të karabinierëve të Mestre-s, atentati lidhej me një rrjet shpërndarjeje droge aktiv në Mirano dhe komunat përreth.

I riu, sipas hetuesve, kishte vendosur të largohej nga kjo veprimtari, kishte gjetur një punë dhe po përpiqej të ndryshonte jetën. Përpara atentatit, ndaj tij kishin nisur kërcënimet, që në muajin shkurt.

Dy të arrestuar për vrasjen e Hotit

Më 28 korrik u arrestuan Luigj Makaj dhe Armiol Gjoka, të cilët hetuesit i konsiderojnë respektivisht porositës dhe ekzekutor material.

Gjatë kontrolleve në banesat dhe automjetet që përdornin dy të arrestuarit, u gjetën municione të të njëjtit kalibër me atë të plumbit të përdorur në vrasje, si dhe materiale që lidhen me aktivitetin e shpërndarjes së drogës.

Emri i Armiol Gjokës ndërkohë e çon hetimin edhe drejt zonës së Jesolos.

Gjoka, një emër i njohur edhe nga një hetim i vitit 2019

Në janar 2019, Gjoka ishte arrestuar së bashku me Lefter Dishën për tentativën e vrasjes së Erblin Dishës, 25 vjeç, ngjarje e ndodhur mes Jesolos, Eracleas dhe argjinaturës së lumit Piave.

Më pas ishte arrestuar edhe Elton Koka. Sipas asaj që u rindërtua gjatë proceseve, motivi lidhej me zhdukjen e një sasie kokaine.

Erblin Disha ishte marrë me forcë, ishte marrë në pyetje dhe ishte qëlluar fillimisht në këmbë e më pas në bark. Më pas ishte braktisur pranë lumit, ku arriti të mbijetojë.

Gjoka, Disha dhe Koka janë dënuar përfundimisht me nga tetë vjet burg secili. Disha dhe Koka ishin përmendur gjithashtu në hetime për trafikun e kokainës në zonën bregdetare të Jesolos dhe në hetimin Eraclea. Sipas akuzës, ata kishin pasur kontakte për furnizimin me të paktën një kilogram kokainë për çdo ngarkesë.

Hetimet po shqyrtojnë tashmë edhe lidhjet mes personave dhe rrjeteve të përfshira në këto episode.

Nga Jesolo në Mirano, emri i Gjokës shfaqet, me një distancë prej shtatë vitesh, në dy raste të tentativave për vrasje që kanë të njëjtin sfond: drogë, borxhe, ndëshkime dhe armë.

Për hetuesit, kjo është një nga hallkat që e bën zonën e Miranos të rëndësishme në rindërtimin e vrasjes së Hotit. Karabinierët po verifikojnë lëvizjet e 35-vjeçarit dhe itinerarin e Fiat Bravo-s, ndërsa hetimi po përqendrohet te marrëdhëniet që ai kishte krijuar në territorin e Venetos.

Në dosjen e tentativës së vrasjes në Zianigo përmendet edhe një person me inicialet E.G., i cili ishte cilësuar si person i tretë nën hetim dhe nuk ishte arrestuar në atë fazë.

Emri i tij lidhet më pas me një operacion të vitit 2020, kur në moshën 29-vjeçare u arrestua në kuadër të operacionit 'Kulmi', një hetim i madh i DIA-s së Barit dhe autoriteteve shqiptare për trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike përmes Adriatikut.

Hetimi për vrasjen e Hotit vijon, ndërsa autoritetet po përpiqen të rindërtojnë të gjithë zinxhirin e marrëdhënieve, lëvizjeve dhe aktiviteteve kriminale që mund të kenë çuar në ekzekutimin e tij.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 11 Shtator18:11

[Erika nga përmblytjet ngre në këmbë banorët e ish-Kënetës në Durrës: Po vijmë shirat, duam investime](#)

Banorët e Durrësit kanë organizuar një protestë mbremjen e së enjtes të mbështetur nga deputetët e PD-së ...

AKTUALITET 11 Shtator18:08

[E kërcënuan në sallën e gjyqit, e ëma e Santiago Malkos bën kallëzim në polici: Më dëmtuan varrin e djalit...](#)

Një hetim i hapur së fundi nga prokuroria e Tiranës, ka vënë në qendër të vëmendjes disa persona që ...

AKTUALITET 11 Shtator17:47

[Qeveria jep 90 mijë m2 me 1 euro për investimin strategjik në Gjirin e Lalëzit](#)

Vendimi parashikon “vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore nr.178/44, nr.152/43 dhe nr.182, në zonë...

AKTUALITET 11 Shtator17:38

[Hita me strukturat në Tiranë, Korçë e Dibër: Godisni grupet kriminale, drogën dhe personat me armë](#)

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skender Hita, në një takim me strukturat e Policisë në Korçë,...

AKTUALITET 11 Shtator17:27

[Plagosje në një pikë kolaudimi në Durrës, ja informacionet paraprake](#)

Një plagosje me mjete të ftohta dyshohet që është regjistruar mesditën e sotme të kolaudimi në Durrës. Ende nuk di...

AKTUALITET 11 Shtator16:23

[Administrativja zhblokoj pagat e magjistratëve, Rama: Sikur të kishte të njëjtën urgjencë për qytetarët](#)

Reagimi i Ramës: Nëse Gjykata Administrative do të kishte një standard për çdo qytetar apo institucion në vështir&eum...

AKTUALITET 11 Shtator16:18

[Rregullorja e re e GJKKO-së përjashtoi njerëzit e medias nga gjyqet, gazetarët njoftojnë për PADI: Kushtetuesja të marrë në dorë situatën](#)

Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë ka njoftuar se të hënën do të depozitojë në Gjykatën Kushtetuese n...

AKTUALITET 11 Shtator16:08

[Detaje të reja nga sherri në Shkozë/ 25-vjeçari po priste në radhë të kolaudimi, autori e qëlloi me kaçavidë](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e sotme në zonën e Shkozëtit ku debati mes disa të rinjve ka agravuar deri në p&...

AKTUALITET 11 Shtator15:40

[Euro prek minimum të ri, thyen për herë të parë edhe pragun e 92 lekëve](#)

Kursi i këmbimit të Euros me Lekun ka zbritur sot për herë të parë poshtë kufirit të 92 lekëve, duke prekur nj&eu...

AKTUALITET 11 Shtator15:25

[Plagoset me thikë 25-vjeçari në Shkozë, arrestohet autori i dyshuar](#)

L Një plagosje me thikë ka ndodhur rreth mesditës në Durrës, në zonën e Shkozëtit. Një i ri, rreth 25 vjeç, &eum...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 10 Shtator

[EMRI/ Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinë...](#)

Përgjegjësia e Cristiano Mossalit për vrasjen e shqiptarit Nexhat Ramës konsiderohet e sigurt, ndërsa ajo që mbetet për t&rsq...

BOTA 10 Shtator

[VIDEO/ Nëna bisedon me shoqen, pak metra më tej...](#)

Ky është momenti tronditës kur një vogëlushe humb jetën pasi shtypet nga një makinë, ndërsa ajo po luante me motr&e...

BOTA 11 Shtator

[Skandali “Dobson”! Si oficerja e burgut i dërgo...](#)

Një oficerë burgu në Britani ka shmangur qelinë, pasi u përfshi në një marrëdhënie intime me një të burgosur...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!



Reagon Cllevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënie të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin në autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtën “shërim” me ujin e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënuar për "shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën "Durrës Marina" dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë "copy-paste"/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i 'errët' i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



"Na detyruan nga Dubai"/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14



Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas



Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi



Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime



Sherr në terminalin e Peshkopisë, shoferi: Mos më vidh pasagjerët! Shko ha bukë te pjesa jote



Artisti dhe Frika



Si u kthye në urrejtje dashuria mes ish-bashkëshortëve dhe ‘lufta’ për 200 mijë euro!

